

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Rasim Rasimi dhe Emine Mustafa, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale të dënuarit L.B., nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 pika 1.1 të KPRK dhe veprës penale të kanosjes nga neni 185 par 3 lidhur me par.1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ushtruar nga i dënuari të paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.269/2014 datë 23.01.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.516/2017 datë 08.06.2017 në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20.02.2018, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit L.B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.269/2014 datë 23.01.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.516/2017 datë 08.06.2017.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin P.nr.269/2014 datë 23.01.2017 të dënuarin L.B. e ka shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 pika 1.1 të KPRK dhe veprën penale të kanosjes nga neni 185 par 3 lidhur me par.1 të KPRK, dhe për veprën e parë penale i ka përcaktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, ndërsa për veprën e dytë penale i ka përcaktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Konform nenit 80 të KPRK të dënuarin L.B. e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro. Është obliguar i dënuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të dënuarit, me aktgjykimin PA1.nr.516/2017 datës 08.06.2017, ka refuzuar ankesën, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve në afat ligjor i dënuari L.B., a paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e atakuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Ndaj kërkesës është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtresën KMLP.II.nr.123/2017 datë 01.08.2017, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga i dënuari L.B. të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa e të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesën e të dënuarit L.B., pretendohet se të dy aktgjykimet janë të kundërligjshme, aktgjykimet janë përfshirë me shkelje të kodit penal dhe kodit të procedurës penale të cilat shkelje janë esenciale dhe të dy aktgjykimet i bëjnë të paqëndrueshme apo të kundërligjshme. Të dy gjykatat si ajo e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, fare nuk janë lëshuar në vlerësimin e pjesës e cila ka të bëjë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale. Aktgjykimi nuk ka asyera të mjaftueshme për çështjet kryesore, arsyet e dhëna dy aktgjykimeve, janë në kundërshtim të tërësishëm me përmbajtjen e provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor.

Më tej në kërkesë pretendohet se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë gabimisht ja kanë falur besimin dhe kanë interpretuar deklaratën e të dëmtuarit N.H. i cili në seancë gjyqësore deklaroi se të dënuarin e ka njohur qysh si ka qenë si fëmijë, dhe se i dënuari ka ngjarë si njëri nga dy personat që i ka sjellë IPOD-in në lokal, por më tej deklaroi se nuk është i sigurt nga ky veprim i kryer nga i dënuari se a ka qenë me të vërtetë i njëjti person. Gjithashtu pretendohet se gjykata nuk e ka marrur parasysh mbrojtjen e të dënuarit ku ka deklaruar se në natën kritike kur ka ndodhur rasti e ka pasur ditëlindjen dhe ka qenë në gjirin familjar duke e festuar dhe nuk ka pasur kurrfarë dyshimi që ka marruar pjesë në atë vjedhje. Ky fakt vërtetohet edhe nga deklaratimet e familjareve të dënuarit dhe një gjë e tillë nuk është provuar me asnjë provë të vetme por vetëm me supozime.

Sa i përket veprës penale të kanosjes i dënuari L.B. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk e ka kërcënuar zyrtarin policor G.B. dhe se nuk ka përdorur asnjë fjalë kërcënuese përveç fjalëve “Nuk është hera e parë që po mi montoni, po mi shpifni dhe pse më keni thirrur mua sa vjedhjet bëhen unë nuk kam faj mu dyshua për ato vjedhje”.

Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë Gjykata Supreme kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore të paraqitura në kërkesë dhe në këtë rast këto pretendime kanë të bëjnë kryesisht me vërtetimin e gjendjes faktike e konform dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për këtë bazë ligjore.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimi i shkallës së parë i vërtetuar me atë të shkallës së dytë nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara nga i dënuari, janë të qarta, konkrete dhe të kuptueshme, në harmoni me vet vetën si dhe arsyetimin, ngase përmbajnë arsyet ligjore lidhur me faktet vendimtare të cilat si të drejta i vlerëson edhe kjo Gjykatë.

Kështu, pretendimi i të dënuarit se gjykata ja ka falur besimin dhe ka interpretuar deklaratën e të dëmtuarit N.H. gabimisht si dhe provave të tjera të cilat nuk e argumentojnë përgjegjësin e të dënuarit dhe se provat materiale që janë në shkresat e lëndës, në fakt shkojnë në favor të dënuarit, nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë nuk e bazon aktgjykimin vetëm në këto prova, por në provat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, e që janë një mori provash tjera. Dëshmitari N.H. ka deklaruar se të dënuarin e ka njohur që kur ka qenë fëmijë, dhe se i dënuari ngjanë si njëri nga dy personat që i kanë sjell IPOD-in në lokal. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se gjatë marrjes së deklaratës në polici, i dëmtuari ka precizuar emrin e të dënuarit, i njëjti ka theksuar se një gjë të tillë e ka identifikuar nga fotografia që i ka ofruar policia sepse emrin nuk ia ka ditur. Gjithashtu kjo deklaratë ndërlidhet edhe me deklaratën e dëshmitarit- zyrtarit policor, G.B., i cili ka qenë duke e hetuar rastin e vjedhjes së rendë, dhe gjatë hetimeve kanë marrë informacione se i dyshuar për këtë veprë penale ka qenë i dënuari L.B.. Gjithashtu me deklaratat e këtyre dëshmitarëve është vërtetuar se gjatë marrjes në pyetje të dënuarit nga zyrtarët policor i njëjti ka pretenduar se janë duke shpifur se nuk është fajtor për veprën penale të vjedhjes, duke ju drejtuar me fjalët “Nuk është hera e parë që po mi montoni, po mi shpifni, e për këtë gjë kur të lirohem do të merremi vesh personalisht unë dhe ti “, e të cilat deklarata korrespondojnë edhe me deklaratën e dëshmitarit Agron Idrizi, i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i kujtohet rasti kur e kanë thirrur të dënuarin për ta intervistuar për veprën penale. Këto deklarata janë vërtetuar edhe me provat materiale sikurse është vërtetimi për marrjen e sendeve, dhe vërtetimit për konfiskimin e sendeve.

Pretendimi se është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, po ashtu nuk qëndron, ngase nga përshkrimi faktik i veprës penale në dispozitiv dhe nga arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë del se në veprimet e të dënuarit formohen elementet e veprës penale të vjedhjes së rendë nga neni 327 par.1 pika 1.1 të KPRK, si dhe veprës penale të kanosjes nga neni 185 par 3 lidhur me par 1 të KPRK, sepse i njëjti gjatë qëndrimit në stacionin policorë i është kanosur zyrtarit policor-rreshterit G.B. me fjalët” ti zotëri këtë punë je duke e bërë për qëllime tuaja personale, se unë nuk jam i dyshuar..., dhe doni me ë ndaluar në burg pa faj, kjo nuk është hera e parë por për këtë do të merremi vesh unë dhe ti kur të dalë nga këtu “me ç, raste ka shkaktuar frikë dhe ankth te i njëjti.

Pretendimi se gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt provat dhe se provat të cilat shkojnë edhe në dobi të dënuarit nuk janë administruar, po ashtu nuk qëndron, ngase të dy gjykatat kanë bërë vlerësimin e drejtë të gjitha provave që janë administruar në shqyrtim gjyqësor për çka kanë dhënë arsyetim të drejtë dhe ligjor.

Nga të gjitha këto që u tha më lart, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit, andaj kërkesa e të dënuarit është refuzuar si e pabazuar dhe konform nenit 437 të të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Procesmbajtësi,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta